

Tema: Pastrimi i parave - detyrimet e përcaktuara për Shqipërinë në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar

E Enjte, 30 qershor 2022, 10:00 – 12:00

Mbi kuadrin institucional dhe kapacitetet në kuadër të procesit të negociatave

- Sugjerohet bashkëpunim dhe bashkërendim më i madh ndërinstitucional sidomos për një Kapitull si kapitulli 24 që përfshin shumë fusha të gjëra dhe të ndërlikuara që nënkupton që dhe barra e punës është më e madhe. Për këtë sugjerohet një ndarje më e mirë dhe proporcionale e detyrave dhe përgjegjësiwe mes institucioneve si dhe stafit të tyre.
- Rekomandohet gjithashtu që të parashikohet dhe krijimi i një stafi të dedikuar lidhur me procesin e monitorimit dhe të raportimit në kuadër të negociatave me Bashkimin Europian dhe të jenë pjesë integrale e Grupeve Ndër-Institucionale të Punës (GNPIE).
- Është e nevojshme rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore që mund të realizohet nëpërmjet trajnimeve dhe workshopeve, ku rol të rëndësishëm të luaj dhe bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile të cilat mund të ofrojnë ekspertizën e tyre në këto fusha.
- Me rëndësi është të ruhet kujtesa institucionale sidomos sa i përket procesit të negociimit dhe raportimit e monitorimit të rekomandimeve dhe prioriteteve në kuadër të procesit të negociatave. Kjo nënkupton që burimet njerëzore të përfshira të jenë të qëndrueshme dhe të mos ketë lëvizje të shpeshta të stafit përgjegjës. Kjo qëndrueshmëri e stafit mund të mbahet nëse do të ketë incentivat dhe mbështetjen e nevojshme, ashtu dhe lehtësim në detyrat e përgjegjësitë e tyre.

Mbi luftën kundër pastrimit të parave

- Paratë të ashtuquajtura të pista kanë nevojë për një ndërmjetës në mënyrë që të përdoren dhe të futen sërish në treg. Përvoja e ndarë nga eksperti slovak dëshmoi se arti dhe veprat e artit përdoren shpesh si një mënyrë për të pastruar këto para. Për këtë sugjerohet që të realizohen politika sa më efektive, të përditësuara me zhvillimet dhe fenomenet e fundit si dhe të bazohen dhe në eksperiencat e vendeve të tjera për të marrë praktikata më të mira.
- Me miratimin e ligjit 27/2018 është ngritur në Shqipëri Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore Materiale dhe ai i Pasurive Kulturore Jo-Materiale. Për ta bërë sa më të dobishëm këtë regjistrer rekomandohet që në të dhënat që mblidhet të përcaktohet qartë autorësia e veprave të artit, si dhe mund të parashikohen sanksione në rast kur shihen shkelje ose mosbashkëpunim për regjistrimin e tyre.
- Është e nevojshme gjithashtu të promovohet sa më shumë **kultura e sinjalizuesve** dhe të krijohet një mjedis ku sinjalizuesit dhe personat që kanë informacion të ndihen të lirshëm dhe të pakërcënuar për të folur dhe për të bashkëpunuar.

- *Trajnimi i stafit me fokus të veçantë këto fenomene janë të nevojshme dhe këshillohet një bashkëpunim dhe me struktura europiane apo shtete të BE-së për të ndarë përvojat me këto vende dhe teknika më të specializuara dhe të dedikuara luftës kundër pastrimit të parave.*
- *Një bashkëpunim më i ngushtë duhet të krijohet dhe mes institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, pasi këto fenomene në pjesën më të madhe të rasteve janë ndërsektoriale pra mund të përfshihet si sektori i veprave të artit, ashtu edhe sistemi bankar, apo pasuritë e paluajtshme apo së fundi kemi dhe një përfshirje të sistemit kripto.*
- *Një regjistër ku të jenë të përfshira të gjitha kompanitë që operojnë në vend duhet të përditësohet dhe të përmirësohet duke pasur parasysh këto elemente sjellë nga eksperiencia sllovaqe:*
 - *Regjistri duhet të jetë publik, online dhe i lehtë aksesueshëm nga të gjithë ku të ofrohet informacion i plotë me të dhëna të nevojshme për të gjithë shareholders të kompanive*
 - *Këshillohet që të regjistrohen edhe kompanitë e huaja që operojnë në tregun shqiptar – në të kundërt humbet efektiviteti i një regjistri të tillë për të hartëzuar dhe identifikuar*
 - *Regjistrimi i kompanive duhet të lidhet ngushtësisht me procesin e verifikimit të tyre. Verifikimi nuk mund të kërkohet për të gjithë kompanitë (ka kosto dhe kërkon shumë kohë) por në raste si në momentin e regjistrimit mund të kërkohet vendosja e dokumenteve të ndryshëm në sistem dhe përditësimi i tyre në mënyrë periodike ose në raste kur kompania përfshihet në prokurime publike.*
 - *Ajo që mund të bëhet tjetër është një kontroll i thjeshtë i të dhënave të vendosura nga kompanitë (adresa, të dhëna për shareholders etj.) dhe në raste kur vihen re problematika atëherë mund të kërkohet verifikim për kompanitë e dyshuara.*
 - *Për këtë proces këshillohet një bashkëpunim i ngushtë me organizatat jo fitimprurëse, firmat ligjore por edhe bankat.*